

**KONTRATE THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**  
**“LEKA TOURS SARANDA” SH.P.K.**

Sot me date 20.01.2022, ne Sarande, me vullnetin TIM te lire une i nenshkruari :

- Kevin Leka, i biri i Aleksandër-it, i datelindjes 30 Qershor 1993 , lindur ne Gjirokastrë te rrethit të Gjirokastrës dhe banues ne Sarande lagjia nr.4 rruga Lefter Talo, godina nr.15, mbajtes i leternjoftimit nr.personal J30630090N, me date leshimi 09 Korrik 2018, i shtetesise Shqiptare.

Ne zbatim te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” ,

**Neni 1**

Vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“Leka Tours Saranda” shpk.**

**Neni 2**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Shërbime si operator Turistikë, transport brenda vendit me mjete motorike te pushuesve, si dhe qeradhenia e mjeteve te ndryshme motorike.

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjeter tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”).

**Neni 3**

Ortake themelues i shoqerise është **z.Kevin Leka.**

**Neni 4**

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 100.000 leke (njeqindmije), perbehet nga një kuota ne pronesi te:

- ✓ Ortakut te vetem te shoqerise z. Kevin Leka, nje kuote ne vleren e 100,000 leke ose 100%, e kapitalit themeltar te shoqerise.

**Neni 5**

Selia e shoqerise eshte ne Sarande, lagjia nr.4, rruga “Mitat Hoxha” Zona Kadastrale nr.8641, Pasuria nr. 23/156+1-N12, Bashkia Sarande.



### **Neni 6**

Kohezgjaria e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe dhe fillon qe nga momei regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### **Neni 7**

**Administrator i shoqerise do te jete z. Aleksia Hysi** i cili do te qendrojne ne kete detyre per 5 vite, me te drejte rizgjedhie dhe eshte i ngarkuar te kryeje akte dhe marre angazhime qe jane ne perputhie me objektin e veprimtarise se shoqerise.

### **Neni 8**

Personaliteti juridik i shoqerise fitohet me regjistrimin e sajë ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i sajë do te filloje pas kryerjes se procedurave ligjore. Ne aktivitetin e shoqerise do ti permbahemi statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoj legjislacionin ne fuqi. Kjo kontrate themelimi u redaktua ne kater kopie, me vlere te njejte ligjore, nje kopie dorzohet prane Qendres Kombetare te Biznesit , dhe nga nje kopie ortaket themelues te shoqerise.

***ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "LEKA TOURS SARANDA" SH.P.K.***

**Kevin Leka** 